

VENDIM
Nr. 17, datë 26.1.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË ‘OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR’, ‘ALBGAZ’ SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 37 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128 prot., datë 21.1.2022, e përparitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror’, ‘Albgaz’ sh.a.”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 30.6.2021, vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 5.1 dhe pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, si më poshtë:

5.1 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE, brenda datës 20.1.2022, provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve, në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Shtyrja u vendos, për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për t’i plotësuar këto kushte në afat.

- Sa i përket kushtit, që lidhet me paraqitjen në ERE, çdo vit ushtrimor, të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin respektiv dhe, si i tillë, ky kusht konsiderohet i plotësuar/përditësuar për vitin 2020 dhe pika 5.1 e vendimit nr. 179/2017 mbetet e pandryshuar.

- Për kushtin që lidhet me bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46(10), i ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se ka qenë në komunikim të vazhdueshëm shkresor dhe verbal me MIE-n, me qëllim përmbushjen e këtij kushti. Po ashtu, “Albgaz” sh.a. informon se është pranë arritjes së një zgjidhjeje të gjithëpranuar nga palët, dhe për këtë arsye kërkon nga ERE shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr. 152/2021, deri në datën 20.11.2022.

- Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 53, pika 3, citon, se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit, që lidhet me pikën 5.2 të vendimit nr. 179/2017, është protokolluar në zbatim të legjislacionit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 152, datë 30.6.2021.

- Për qëllime të kësaj kërkesë, shoqëria ka dhënë sqarime për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve deri në datën 20.11.2022.

- Në vijim, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE, çdo tre muaj, informacion për përpjekjet konkrete të bëra në lidhje me realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 5.2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

“5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE, brenda datës 20.11.2022, provat dokumentare për bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe transferimin e kompetencave të Ministria e Ekonomisë dhe Financave.”.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të dërgojë në ERE, çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, informacion për përpjekjet konkrete të bëra, në lidhje me realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor.

3. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.1.2022.

4. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë aplikuesin dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti